



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201400992/5

Tiranë ____/____/2014

Lënda: *Rekomandojmë marrjen e menjëherëshme të masave për dhënien e pagesës së aftësisë së kufizuar përfituesve pranë Komunës Shalë, Dukagjin.*

Drejtuar : Z. Paulin RADOVANI
Prefekt i Qarkut

SHKODËR

Kryetarit të Këshillit të Komunës Shalë

DUKAGJIN

Për dijeni: Z. Bale VUKSANI
Kryetar i Komunës Shalë

DUKAGJIN

Të nderuar zotërinj,

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi S.V, me objekt: mosdhënien e së drejtës për të përfituar pagesën e aftësisë së kufizuar.

Sipas shpjegimeve të tij, është invalid tetraplegjik, grupi i parë dhe është përfitues i të drejtave ligjore që rrjedhin nga gëzimi i Statusit të Invaliditetit Paraplegjik-Tetraplegjik. Nuk ka përfituar pagesën e aftësisë së kufizuar që nga muaji Janar 2014 dhe kjo ka krijuar barriera, duke mos perballuar dot nevojat me imediate të jetesës së përditshme, pasi ajo pagesë është e vetmja e ardhur e tij.

Duke e konsideruar këtë çështje si shkelje të të drejtave të ligjshme të tij, ka kërkuar ndihmën e Avokatit të Popullit.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj si dhe në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, ka vendosur pranimin e ankesës dhe shqyrtimin e saj

Për nevojat e shqyrtimit të kësaj ankesë, kërkuam shpjegime pranë Kryetarit të Komunës Shalë, Dukagjin mbi arsyet e mosdhënies së pagesës së aftësisë së kufizuar që nga muaji Janar 2014 shtetasit S.V.

Në përgjigje të kërkesës sonë, informohemi se Këshilli i Komunës Shalë nuk mbledhet për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të përcaktuara ligjore që nga data 24.06.2013. Për dhënien e ndihmës ekonomike dhe pagesës së aftësisë së kufizuar për vitin 2013, me ndërhyrjen e Prefektit të Qarkut dhe Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, u arrit konsensusi për miratimin e ndihmës ekonomike dhe pagesës së aftësisë së kufizuar.

Aktualisht, për vitin 2014, çdo muaj është bërë kërkesë nga Kryetari i Komunës Shalë për mbledhjen e Këshillit për miratimin e ndihmës ekonomike dhe pagesës së aftësisë së kufizuar si edhe për çështje të tjera në shërbim të komunitetit, por nuk ka patur asnjë reagim pozitiv. Edhe mbledhja e datës 29.04.2014 nuk u arrit të realizohej, pasi mungonin 8 këshilltarët e Komunës Shalë.

Pra, siç konstatohet nga ky informacion i marrë, mosdhënia e pagesës së aftësisë së kufizuar, ka ardhur si rezultat i mosfunksionimit të Këshillit të Komunës Shalë.

Ky qëndrim i mbajtur nga ana e Këshillit të Komunës, konsiderohet si një veprim, i cili vjen në kundërshtim të hapur me ligjin.

Bazuar në Ligjin nr. 9355 datë 10.03.2005 “Për Ndihmën Ekonomike dhe Shërbimet Shoqërore”, i ndryshuar, në nenin 20, pika 1, thuhet shprehimisht se:

“Ndihma ekonomike dhe pagesa e personave me aftësi të kufizuar, shpërndahen një herë në muaj me vendim të këshillit të qeverisjes vendore”.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 59, pika 1/ “e” dhe “f”, ka përcaktuar si objektiva sociale të shtetit, edhe :

*e. përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët,
f. riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve, si dhe përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës.*

Me qëllim që personat me aftësi të kufizuar të përfitojnë të drejtat e tyre ligjore, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcakton se “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe nenit 21/b ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet

rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”:

REKOMANDOJM Ë:

Marrjen e masave të menjëherëshme për dhënien e pagesës së aftësisë së kufizuar përfituesve pranë Komunës Shalë, Dukagjin.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se;

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet të shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”,

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin ndaj këtij rekomandimi.

Me besim në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI